

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim, që diskutimi i marrëveshjeve financiare IPA është një moment i rëndësishëm për Shqipërinë dhe ne duhet të shprehim mirënjohjen ndaj Bashkimit European për të gjithë mbështetjen që i ka dhënë Shqipërisë ndër vite nëpërmjet instrumentit të paraaderimit. Në qoftë se do të analizojmë sot sesa prioritet e ka integrimin qeveria, mos harroni që në vitin 2017 ajo e shkriu Ministrinë e Integritimit. Shkriu një ministri të tërë, sepse ne duhet ta themi, që qeveritë kanë prioritete me vendimmarrjet e tyre, duke e atashuar atë ministri afër Ministrisë së Jashtme, dhe tani gjysma e dikasterit është në Ministrinë e Jashtme, gjysma është në Kryeministri.

Pra, me këto vendimmarrje kuptojmë se sa prioritet ka qenë dhe është procesi i integritimit european, dhe pa dyshim mbështetja e jashtëzakonshme që jep BE-ja për avancimin e Shqipërisë më tej. Por le të kthehemi te deklarata shumë e rëndësishme, që bëri drejtuesja e BE-së para disa ditësh, për mbështetjen e jashtëzakonshme prej 100 milionë eurosh të dhëna për arsimin, sepse i gjithë Bashkimi European e quan arsimin dhe edukimin si investimin më të madh, që duhet të bëjë një komb për të ardhmen e tij. Por çfarë ndodhi këtë 12 shtator? Si u gjend arsimi më 12 shtator? Përsëri me probleme shumë të mëdha, përsëri me vështirësi shumë të mëdha, për një shkak të vetëm, keqqeverisjen. Janë 58 mijë nxënës më pak se 5 vjet më parë.

Janë 11 mijë maturantët që kanë zgjedhur Bashkimin European dhe jo Shqipërinë për të studiuar, duke dhënë një mesazh shumë të qartë, për dështimin e politikave në sistemin arsimor. Dhe kur flasim për prioritet arsimin, flasim se sa buxhet i japim arsimin, jo propagandë, sa e duam ne edukimin apo dijen. Sot në Shqipëri, jemi me buxhetin më të pakët në rajon për sa

i përket arsimit. Në qoftë se e ke prioritet një sektor, jepi buxhet, ndryshe nuk e ke prioritet, e ke thjesht dhe vetëm propagandë. Të mos flasim kur vijnë akte normative, kur buxheti i parë që preket është arsimit, siç ndodhi me paketën e parë të rezistencës, ku u shkurtuan 15 milionë dollarë nga buxheti i arsimit.

Kam qenë për të mos u prekur ai buxhet, por u prek buxheti i arsimit. Të mos flasim për braktisjen e shkollave. I kemi parë të gjitha kronikat televizive dhe jemi të vetëdijshëm që në rrethe qindra shkolla u mbyllën për shkak se nxënësit largohen. Çfarë ndodh në disa komuna apo vende të largëta? Ka klasa kolektive, ku një nxënës i klasës së parë, bën mësimin me një nxënës së klasës së shtatë apo të tretë. Të mos flasim për analfabetizmin funksional në nivele alarmante. Të mos flasim që kjo qeveri nuk ka krijuar as kushtet më minimale për një mësim dinjitoz dhe të standardeve europiane. Mësimi bëhet me turne. E patë te shkolla “Kongresi i Lushnjës” përplasjen e mësuesve me prindërit, për faktin që u kishin ndryshuar turnin e mësimin nxënësve?

Prindërit duhet të shkojnë të punojnë apo të shkojnë të shoqërojnë fëmijët në shkollë, se u ndryshohen çdo vit turnet e mësimin në shkollat tona? Mungesa e internetit në 50% të shkollave rurale. Mungesa e bazës mësimore, e laboratorëve. I keni kthyer fëmijët tanë në nxënës që mësojnë përmendësh, që nuk argëtohen duke u edukuar, por flustrohen. Të mos flasim pastaj për rastin e fundit, ku kam qenë dëshmitare, që shkolla “Ibrahim Basha” në Kamëz, ditën e parë nuk u hap, ku 900 nxënës, që nga 22 marsi, shkojnë nëpër shkolla të tjera, sepse shkolla e tyre nuk është gati, asnjë punim nuk është kryer në atë shkollë. Ndërkohë që kjo vendimmarrje ka sjellë një kosto shtesë për ato familje, 30 mijë lekë më shumë në muaj.

Ata fëmijë shkojnë në shkolla që janë gjysmë ore apo një orë larg. Çfarë kërkova? Çfarë kam kërkuar edhe me letër, adresuar edhe kryetarit të bashkisë, edhe ministres? Kam kërkuar që të bëhet shkolla. Po çfarë pretendimi ngrihet? Ngrihet pretendimi se paska qenë për shkak të rindërtimit, për shkak të tërmetit, që ka ndodhur 2 vjet më parë. Atëherë, pyetja shtrohet: si i kemi lënë këta fëmijë 2 vjet në atë shkollë që rrezikohet? Në qoftë se është i vërtetë ky pretendim, pse vetëm më 22 mars këta fëmijë u larguan nga ambientet e shkollës? Kjo është

pyetja. Pra, dy vjet ne i kemi lënë këta fëmijë nën rrezikun e një godine, e cila është e papërdorshme sipas argumentimit të drejtuesve të bashkisë.

Po çfarë kërkojnë qytetarët? Ata kërkojnë transparencë, kërkojnë llogari. Shumë mirë, të bëhet shkolla, të rindërtohet edhe me mbështetjen e Bashkimit Europian, me mirënjohje, por duan të dinë kur është tenderimi dhe kur do ta kenë shkollën e tyre ata fëmijë. Dhe mos ia hidhni fajin Bashkimit Europian, sepse mjafton një bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Europian për të përshpejtuar procedurat. Duhet pasur vullnet, që ata fëmijë ta kenë sa më parë shkollën. Duhet të dinë një datë, kur ata do të mund të rihyjnë në një jetë normale. Çfarë kemi kërkuar tjetër? Për shkak të kësaj vendimmarrjeje është shtuar kostoja për familjet, atëherë të merret parasysh kjo kosto dhe të rimbursohen familjet.

Ndërkohë që është kjo problematikë, çfarë pamë sot? Pamë pedagogët në protestë, një akt dinjitoz i tyre. Mendoj se intelektualët e këtij vendi duhet të jenë të parët që duhet të flasin për shumë nga gjërat që ndodhin në këtë vend, sepse janë modeli më i mirë, që mund t'i japin çdo studenti kurajën për të kërkuar llogari dhe për të protestuar për të drejtat e tyre. Çfarë kërkojnë ata? Kërkojnë rritje rrogash në nivelin e Kosovës, për të pasur dinjitet në punën e tyre, asgjë më shumë. Madje kanë kërkuar që vitin e parë të bëhet 30% shtesë dhe vitin e dytë 20% shtesë. Çfarë kërkojnë tjetër? Kërkojnë kërkim shkencor, rritje të fundit të kërkimit shkencor. Dhe pse kërkohet që vëmendja të shkojë drejt arsimit?

Sepse po braktiset ky vend, po braktiset nga të rinjtë, të cilët po largohen me gomone nga ky vend, me pamje të dhimbshme, ndaj duhet vëmendja tek arsimit. Asnjë krizë nuk mund të prekë buxhetin e arsimit, por ai duhet të kthehet në prioritet kombëtar. Silleni 5% buxhetin për arsimin dhe do ta votojmë të gjithë. Ta çojmë në nivelin 5% të paktën. Në qoftë se flasim pastaj për tekstet, ku propaganda thoshte: “tekste falas”, unë ju kam sjellë disa tekste, por tekstet falas janë të përdorura. Boll mashtruat! Këto janë tekste të përdorura. Kur raportoni në delegacionin apo në Bashkimin Europian thuajeni që janë tekste të përdorura, nuk janë falas. Shikojini, janë me stilolaps dhe nuk mund të përdoren nga fëmijët, që kanë qarë ditën e parë të shkollës, sepse nuk kishin libra.

Cila është përgjigjja e Kryeministrit për këtë gjë? “Do t’i sanksionojmë fëmijët”. Kë do të sanksionosh? Duhesh sanksionuar ti, zotëri, që ke mashtruar me një politikë të dështuar me librat falas, dhe këtë duhet ta pranosh. Çfarë thotë Kryeministri? Thotë: “Po, kam lekë, kam edhe buxhet, por nuk e përdor çdo vit për libra të rinj falas”. Jo, sepse thotë që duhet t’i edukojmë këta fëmijë. Kjo deklaratë është shumë e turpshme. Fëmijët tanë, zoti Kryeministër, librin e kanë identitet të rritjes së tyre, ku të kenë mundësi të shënojnë, të nënvizojnë dhe të plotësojnë ushtrimet, sepse është pjesë e identitetit dhe e formimit të tyre.

Ju, më shumë se kushdo tjetër duhet ta dini këtë gjë, pasi nuk lini letër pa vizatuar kudo që shkoni. Ndaj, të nderuar kolegë, arsimin duhet ta kthejmë në prioritet kombëtar. Ndryshe, largimi i të rinjve, dëshpërimi i tyre për të pasur një jetë, një shpresë në këtë vend, do të venitet gjithnjë e më shumë. Mendoj se koha e llogaridhënies për secilin prej jush ka ardhur. Faleminderit!